

Data 16.06.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Blerje protoksid Azoti

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Produkte farmaceutike 33600000-6

Gazra Mjekësore 24111500-0

VLERA E FONDIT LIMIT(vlera e pritshme e kontratave që mund të lidhen) :

2 961 000 (dymilioneenenteqindeegjashtedhjetenjemije)leke Pa tvsh

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,autoriteti/enti kontraktor Spitali Lushnje ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

FONDI LIMIT (vlera e pritshme e kontratës që mund të lidhen): **2 961 000 (dy milione e nente qinde e gjashtedhjte e nje mije)leke Pa tvsh**

Fondi limi është përlllogaritur bazuar në V.K.M. nr .285, Datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 76 ”Mënyrat për përlllogaritjen e vlerës së prokurimit” pika 1.Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave, simë poshtë vijon: gërma c)cmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; . Në rastin konkret Autoriteti Kontraktor në përlllogaritjen e fondit limit është bazuar në cmimet e kontratave të mëparshme të lidhura vetë nga vetë institucioni (kontrata Nr. 248 Prot datë 08.03.2021)pasqyruar në procesverbalin Nr.1261/2 Prot datë 31.12.2021 i Grupit të punës për përlllogaritjen e fondit limit, kërkesën me Nr.1261/1 datë 28.12.2021 të Shefit të Shërbimit të Reanimatorit.

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës3;

c. Formulari i ofertës, sipas Shtojcës 1;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kriterëve të përgjithshme të pranimit/kualifikimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, si dhe nenit

(Shënim: përcaktoni **nëse është rasti**, aktin konkret ligjor ose nënligjor që parashikon plotësimin e ndonjë kërkesë specifike për ushtrimin e veprimtarisë profesionale që lidhet me objektin e prokurimit).

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e fondit limit që prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti Kontraktor ka konsideruar të nevojshme përfshirjen e kriterit cituar më lart, në mënyrë që t’i shërbejë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomik pjesëmarrës të mundshëm si dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës. Kërkesa është në përpjestim dhe e lidhur ngushtë me objektin e kontratës

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Bazuar në nenin 43 pika 2/c të V.K.M. Nr. 285, datë 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet :

Neni 43 pika 2/c : Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohe operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: c. 40% të vlerës së parashikuar të kontratës në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit ”Shërbim Konsulence”.

Neni 43 pika 5 : Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesapër xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të

zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen , mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 9920 date 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Përmbushja e njërit prej kriterëve të mësipërme e bën ofertën të vlefshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 55 pika 4 b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Në bazë të V.K.M –së nr. 285, datë 19.05.2021 " Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik", **neni 55 pika 4b** ku përcaktohet se ; Për kontratat e mallrave e shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jomë të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

2.3.2. Deklarate per origjinen e mallit ku te percaktohet vendi i i prodhimit dhe kompania prodhuese.

(Ky kriter vendoset me qëllim njohjen e origjinës së mallit dhe kompaninë prodhuese për të identifikuar në mënyrë të qartë atë gjatë lëvrimin të tij dhe për të pasur sigurinë që i njëjti mall i ofertuar do të lëvrohet në destinacion në përputhje me nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. dhe keto kërkesa i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE për përmbushjen me sukses të kontrates pra te garancise.

2.3.3. Ofertuesi duhet të paraqese autorizim nga prodhuesi i mallrave (ose distributori i autorizuar prej prodhuesit) për lejin e tregtimit të mallrave të kërkuara në specifikimet teknike, të perkthyer dhe noterizuar. Në rast se OE është vet prodhues, duhet të paraqesevetedeklarim me shkrim.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar për të njohur origjinën e mallrave dhe për të vërtetuar lidhjen e OE me prodhuesin ose distributorin e autorizuar, bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe neni 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021.

2.3.4. Vertetim për regjistrim dhe kontroll nga inspektoriati i paisjeve nën presion, përplotësimin e kushteve teknike dhe të sigurisë konform legjislacionit në fuqi që vepron në RSH.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar për të vërtetuar që operatori vepron sipas legjislacionit në fuqi bazuar në nenin 40, pika 8 të VKM 285 datë 19.05.2021 i ndryshuarsi dhe ka kapacitetet teknike për ruajtjen e mallit sipas standartit të kërkuar në specifikimet teknike.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuar, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

- **Përmbajtja e N₂O jo më pak se 99.5%**
- **Përmbajtja e No jo më pak se 0.0001%**
- **Përmbajtja e No₂ jo më shumë se 0.0001%**
- **Përmbajtja H₂O jo më shumë se 0.4mg/l**
- **Përmbajtja NH₃ jo më shumë se 0.001%**
- **Përmbajtja CO₂ jo më shumë se 0.01%**
- **Përmbajtja CO jo më shumë se 0.001%**
- **Përmbajtja halogjeneve dhe H₂S jo më shumë se 0.0001%**

- **Përmbajtja e PH3 dhe AsH3**
- **Përmbajtja e bazave dhe acideve**
- **Përmbajtja e lëndëve oksiduese dhe reduktuese**
- **Furnizimi i protoksidit do të jetë me bombula me kapacitet 27 KG**
- **Cdo furnizim me protoksid azoti duhet të jetë i shoqëruar me fletë analize**

Paketimi I Protoksidit të azotit do të bëhet me bombulat e shitësit.

Shitësi e ka përdetyrë të mirëmbajë, kolaudojë dhe riarojë bombulat me shpenzime të veta në përputhje me rregulloren përkatëse të miratuar nga Inspektorati Shtetëror I eneve nën presion.

Protoksidi I azotit do të jetë në bombula mbi të cilat do të jenë të stampuara pesha neto e bombulës.

Transporti dhe shkarkimi I bombulave të kryhet nga firma deri Brenda në magazinën e spitalit.

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në përputhje me nenin 36 pika 1 të ligjit Nr.162 datë 23.12.2020 “për prokurimin publik” ku përcaktohet se :Specifikimet teknike sic përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurorhet. Keto karakteristika mund të lidhen dhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur keto faktorë nuk nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj si dhe në nenin 40 pika 2 të V.K.M. Nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe janë vendosur nga specialisti i fushës në përputhje me mallin që prokurorhet (prototoksid azoti si dhe nga anëtarët e njësisë së prokurimit në përputhje me legjislacionin aktual në fuqi.

Afati kohor për dorëzimin e ofertave ose kërkesave për pjesëmarrje apo hapjen e tyre :

Data: 29.06.2023 Ora: 10:00

NJESIA E PROKURIMIT